



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KRYETARI

Nr. 3987/prot.

Himarë, më 02.06.2026

URDHËR  
Nr. 298 Datë 02.06/2026

PËR

**“KUFIZIMET NË QARKULLIMIN E MJETEVE RRUGORE TË RËNDA TË TRANSPORTIT MALLRAVE/PERSONAVE GJATË SEZONIT TURISTIK”**

Mbështetur në pikën 2 të nenit 113 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjin 8378/1998 “Kodi rrugor i Republikë së Shqipërisë”, ligjin 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin 93/2015 “Për turizmin”, VKM-së Nr.153/2000 “Rregullorja për zbatimin e Kodit Rrugor”, Udhëzimit të përbashkët Nr.7967/2018 “Mbi kufizimet në qarkullimin e mjeteve të rënda për transportin e mallrave përgjatë sezonit turistik” dhe VKB Himarë Nr.15 datë 28.04.2026 “Për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e sukseshëm të sezonit turistik 2026 dhe planit të veprimit përkatës”. Me qëllim sigurimin e një sezoni të qëndrueshëm, krijimin e një mjedisi miqësor për pushuesit vendas dhe të huaj, duke eliminuar pengesat dhe bllokimet si rrjedhojë e qarkullimit të rënduar gjatë sezonit turistik:

**URDHËROJ:**

- 1- Të ndalohej për periudhën 25/06/2026 deri më 15/09/2026, qarkullimi i mjeteve rrugore të rënda për transportin e mallrave/personave mbi 3.5 tonë (duke përfshirë por pa u limituar, auto betoniere, autovinça, eskavatorë, fugonë, autobusa, kamionë, etj.), me përjashtim të mjeteve të emergjencës, shërbimeve publike dhe rasteve të autorizuara me leje të posaçme nga autoritetet përkatëse, në segmentin e Unazës së Vogël të qytetit Himarë.
- 2- Të devijohet qarkullimi i mjeteve rrugore të rënda për transportin e mallrave/personave mbi 3.5 tonë ( duke përfshirë por pa u limituar: auto betoniere, autovinça, eskavatorë, fugonë, autobusa, kamionë, etj.) në segmentin e unazës së madhe të qytetit Himarë.
- 3- Subjektet e licensuara për transportin e personave të marrin masa për njoftimin e pikave të ndalimit sipas orarit zyrtar të miratuar.
- 4- Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Policisë Bashkiake Himarë, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Vangjel Favo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KRYETARI

Nr. 3987 prot.

Himarë, më 02.06 2026

**URDHËR**

Nr. 297 Datë 02.06/2026

**PËR**

**“KUFIZIMET NË QARKULLIMIN E MJETEVE RRUGORE TË RËNDA TË  
TRANSPORTIT MALLRAVE/PERSONAVE GJATË PERIUDHËS 05/06/2026  
DERI MË DATË 25/06/2026”**

Mbështetur në pikën 2 të nenit 113 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjin 8378/1998 “Kodi rrugor i Republikë së Shqipërisë”, ligjin 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin 93/2015 “Për turizmin”, VKM-së Nr.153/2000 “Rregullorja për zbatimin e Kodit Rrugor”, Udhëzimit të përbashkët Nr.7967/2018 “Mbi kufizimet në qarkullimin e mjeteve të rënda për transportin e mallrave përgjatë sezonit turistik” dhe VKB Himarë Nr.15 datë 28.04.2026 “ Për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e sukseshëm të sezonit turistik 2026 dhe planit të veprimit përkatës”. Me qëllim sigurimin e një sezoni të qëndrueshëm, krijimin e një mjedisi miqësor për pushuesit vendas dhe të huaj, duke eliminuar pengesat dhe bllokimet si rrjedhojë e qarkullimit të rënduar gjatë sezonit turistik:

**URDHËROJ:**

- 1- Të ndalohet qarkullimi i mjeteve rrugore të rënda për transportin e mallrave/personave mbi 3.5 tonë (duke përfshirë por pa u limituar, auto betoniere, autovinça, eskavatorë, fagonë, autobusa, kamionë, etj.), duke filluar nga data 05/06/2026 dhe deri më datë 25/06/2026, gjatë fundjavave nga ora 14:00 e ditës së Premte deri në orën 06:00 të ditës së Hënë, në segmentet rrugore të Njesisë Administrative Himarë dhe Njesisë Administrative Lukovë, me përjashtim të mjeteve të emergjencës, shërbimeve publike dhe rasteve të autorizuara me leje të posaçme nga autoritetet përkatëse.
- 2- Subjektet e licensuara për transportin e personave të marrin masa për njoftimin e pikave të ndalimit sipas orarit zyrtar të miratuar.
- 3- Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Policisë Bashkiake Himarë, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
Vangjel Tavo

